

FJALA E DEPUTETIT SALI BERISHA

E ENJTE 28 KORRIK 2022

Vendimi për të shkelur në mënyrë flagrante Rregulloren e parlamentit, e cila në nenin 110, pika 4, garanton debatin për programin dhe përbërjen e Këshillit të Ministrave, është një akt i pashembullt, dhunim flagrant i së drejtës së deputetit për debat në këtë parlament dhe vendim që merret në kuadrin e monizmit të plotë të vendosur nga maxhoranca e drogës dhe krimin.

Në këtë rast unë dua t'i them Edi Ramës: çfarëdolloj xhakete të veshësh e të zhveshësh, asnjë nuk ta heq ty qyrkun e vjedhësit. Ti kërkon t'u mohosh deputetëve të drejtën e fjalës vetëm e vetëm se, nëse do të flisnin, do t'u faktonin shqiptarëve se padrinoja i Arben Ahmetajt e ka emrin tenderbegu Edi Rama.

Zonja Kryetare, në emër të ligjit të këtij parlamenti, duhet ta hapni debatin, siç e parashikon Rregullorja, dhe mos e përdorni arbitraritetin. Çështja e djegësve është një problem themelor, madhor. Të mos mendojë Edi Rama se, duke i shpëtuar gjykimit këtu në parlament, do t'i shpëtojë gjykimit në sheshet dhe rrugët e Shqipërisë. Unë ju garantoj se kjo nuk do të ndodhë kurrë.